

**ROMANI “NGRITJA E SKËNDERBEUT” (THE RISE OF ISKANDER, 1833)  
I SHKRIMTARIT ANGLEZ BENXHAMIN DIZRAELI-T.  
NJË ZBULIM I RI ALBANOLOGJIK.**

**Robert Elsie**

Për albanologët ka mbetur krejtësisht i panjohur deri tani një roman anglez i shekullit të kaluar mbi temën e Skënderbeut, megjithëse autori i romanit ka marrë famë në Angli dhe në tërë botën jo vetëm si shkrimtar, por edhe si burrë shteti.

Benxhamin Dizraeli (Benjamin Disraeli, 1804-1881), kryeministri i Anglisë në kohën e Mbretëreshës Viktoria, është një ndër figurat më të spikatura të politikës britanike të shekullit të kaluar. Ky politikan i shkathët, i emëruar më vonë Lord Bikënsfild (Lord Beaconsfield), ishte përfaqësues i Britanisë së Madhe në Kongresin e Berlinit në korrik të vitit 1878. Synimi i Dizraeli-t në këtë Kongres të fuqive të mëdha ishte në radhë të parë për të luftuar kundër ekspansionizmit të Ruisë Cariste duke kundërvënë shpërbërjen e plotë të Perandorisë Osmane. Është ky fakt që kërkesat e shqiptarëve të drejtuara atij në *Memorandum degli Albanesi*<sup>1</sup> mbetën pa përgjigje.

Dizraeli ishte jo vetëm politikan por edhe një shkrimtar mjaft i lexuar në epokën “viktoriane” me romane dhe tregime të shkruara më shijen e kohës. Në vitet 1830-1831, si burrë i ri, ai kishte ndërmarrë një udhëtim të gjatë në vendet e Mesdheut dhe të Lindjes së Mesme. Kështu, në tetor të vitit 1830 erdhi nga Korfuzi në Janinë, në kryeqytetin e Shqipërisë së Jugut në atë kohë, për një vizitë që e përshkroi me shumë emocione në letrat e tij të derguara në Angli<sup>2</sup>. Pas kësaj “jave të mrekullueshme” siç e cilësoi, dhe me siguri nën ndikimin e Lord Bairon-it (Lord Byron, 1788-1824), Benxhamin Dizraeli vendosi ta trajtojë temën e Skënderbeut në romanin e shkurtër “Ngritja e Skënderbeut” (*The Rise of Iskander*), të cilin ai mbaroi në qytetin anglez të Bathit në dimrin e vitit 1832-1833. Atë e botoi së bashku me një roman tjetër në Londër në vitin 1833<sup>3</sup>.

*Ngritja e Skenderbeut*, në stilin e romaneve të ashtuquajtura “mesjetare” të shkrimtarit skocez Sër Ualter Skot (Sir Walter Scott, 1771-1832), është më shumë një vepër romantike se sa një roman historik. Fillon me vizitën e Skënderbeut natën tinëz në kampin e Janosh Huniadit për të përgatitur kryengritjen e Epirotëve dhe me kthimin e tij në Krujë. Tema kryesore e romanit është çlirimi dhe shpëtimi nga Iskanderi, tani Princi i Epirotëve, dhe nga miku i tij Nikaiusi, Princi i Grekëve, e Princeshës Iduna, vajza e Huniadit, e cila është e burgosur në haremin e turqve në Edirne (Adrianopël).

Ky roman i shkurtër prej 22 kapitujsh dhe prej 113 faqesh është vepra kryesore e prozës angleze të shekullit 19 me temën e Skënderbeut, dhe, me gjithë se nuk kishte një sukses të madh, u ribotua anglisht të paktën 13 herë<sup>4</sup>. Gjithashtu u përkthye dy herë greqisht<sup>5</sup>,

<sup>1</sup> *Memorandum degli Albanesi indirizzato a S. E. Lord Beaconsfield, Primo Ministro Rappresentante di S. M. La Regina d'Inghilterra al Congresso di Berlino* (Scutari, 13 qershor 1878), 19 faqe.

<sup>2</sup> Ralph Disraeli, (bot.) *Lord Beaconsfield's letters, 1830-1852. New edition of the Home Letters and notes, with a portrait, edited by his brother* (J. Murray, Londër 1887), 248 faqe.

<sup>3</sup> Benjamin Disraeli, *The wondrous tale of Alroy, The rise of Iskander*, by the author of *Vivian Grey*, *Contarini Fleming* etc. (Saunders and Otley, Londër 1833). 3 vëllime.

<sup>4</sup> Filadelfia 1842, Londër 1871, Boston 1874, Londër 1881, Boston 1887, Londër 1888, Londër 1890-1891, Boston 1900, Londër 1900, Londër & Nju Jork 1904-1905, Londër & Nju Jork 1919, Londër 1926-1927 dhe Nju Jork 1927.

dhe një herë sllovenisht<sup>6</sup>. Në shekullin e njëzetë romani filloi të humbë pëlqimin e lexuesve, pasi shija e publikut ndryshoi me kohë.

Ka shumë të ngjarë që Dizraeli ta ketë dëgjuar emrin e Skënderbeut për herë të parë jo në Janinë, por në veprën e historianit të famshëm anglez Eduard Gibënz (Edward Gibbons, 1737-1794), *Historia e Rënies dhe e Rrëzimit të Perandorisë Romake*<sup>7</sup> e cila lexohej shumë në Anglinë e shekullit XIX dhe veçanërisht nga turistët anglezë gjate udhëtimeve nëpër Evropën Jugore. Nën ndikimin e Gibënz-it ishte jo vetëm Dizraeli, por edhe Lord Bairon, i cili pas një serë skandalesh dashurie të shfrenuara në Angli, u detyrua të emigronte në Evropë ku mbretëronte tolerancë seksuale më shumë. Edhe Lord Bairon kishte ardhur në Shqipërinë e Jugut në kohën e Ali Pashë Tepelenës (1741-1822), Asllanit të Janinës. Botimi i parë i poemës së gjatë *Çaild Harëldz Pilgrimëxh*<sup>8</sup>, ku përmenden Shqipëria dhe Skënderbeu, ishte një sukses i jashtëzakonshëm në Angli, dhe ka ndikuar edhe në formimin e Dizraelit,

Më interes në veprën *Ngritja e Skënderbeut* është fakti se heroi kombëtar shqiptar del jo si një shqiptar por si një princ grek. Bile fjala *shqiptar* përdoret në roman vetëm një herë në një përshkrim të veshjeve të Skënderbeut: *Mbante një këmishë të bardhë jo të rrallë për Shqiptarët*. Duhet theksuar edhe një herë se kemi të bejmë më një roman krejtësisht sentimental pa bazë historike në përgjithësi.

Nga përshkrimi i sotëm, *Ngritja e Skënderbeut* nuk është një vepër letrare më cilësi të lartë. Megjithatë në fushën e Albanologjisë kjo vepër e Dizraelit ka një rëndësi të veçantë, dhe është për t'u habitur që ky roman nuk është përmendur fare në studimet përkatëse mbi Skënderbeun<sup>9</sup>. *Ngritja e Skënderbeut* është rasti i parë dhe shembulli më i spikatur në prozën angleze i një adaptimi letrar të temës së Skënderbeut. Në të njëjtën kohë është e para vepër, ndoshta e vetmja, e prozës letrare angleze me një temë shqiptare. I shikuar nga ky këndvështrim, romani i Dizraelit është një përmendore e rëndësishme e marrëdhënieve letrare dhe kulturore anglo-shqiptare që me guxim mund ta emërojmë si zbulimi letrar i Shqipërisë në shekullin XIX<sup>10</sup>.

Robert Elsie  
Gjermani

[botuar në: *Hylli i Dritës*, Tiranë, 2-3 (1993), f. 113-115; ribotim në: *Zëri*, Prishtinë, 27.03.1993.]

---

<sup>5</sup> *Hê anabasis tu Skender ê Geôrgiu Kastriotû, diêgêma syggrafen hypo Beniamin Disraeli, nyn komptos Bêkonsfêld, metafrasthen ek tu agglïku hypo P. Lakkiôtu* (Ho Kadmos, Patras 1880), 100 faqe; dhe *Hê Antaaria tu Skentermpei: ponêma tu Lordu Vekonsfild kata metafrasin Iô. G. Pappa* (Leukôsia 1890), 130 faqe.

<sup>6</sup> *Vstaja Skenderbeg: zgodovinska povest* (Katoliska Bukvarna, Lubljana 1910), 108 pp.

<sup>7</sup> Edward Gibbons, *History of the Decline and Fall of the Roman Empire*, Londër 1776-1778, vëllimi i pestë, f. 401-406.

<sup>8</sup> Lord Byron, *Childe Harold's Pilgrimage* (1812-1819).

<sup>9</sup> Georges Petrovitch, *Scanderbeg (Georges Castriota). Essai de bibliographie raisonnée* (Paris 1881 / Mynih 1967); B. B. Ashcom, Notes on the development of the Scanderbeg theme, në: *Comparative literature*, Eugene, Oregon, 5 (1953), f. 16-29; Skënder Luarasi, *Skanderbeg in English language*, në: *Studia Albanica*, Tiranë, 4.2 (1967), f. 229-234; dhe Androkli Kostallari, *La figure de Skanderbeg dans la littérature mondiale*, në: *Studia Albanica*, Tiranë, 1 (1988), f. 191-215.

<sup>10</sup> Për ta lehtësuar konsultimin e veprës në Shqipëri dhe për t'i thelluar studimet mbi Skënderbeun në letërsinë botërore, iu dhurua në nëntor 1991 një fotokopie e romanit Bibliotekës Kombëtare të Tiranës.